

Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 37 (2, 3, 4) dhe Rregullores (QRK) Nr. 03/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar, Neni 8, Komuna Hani Elezit shpall :

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Grupi i planifikimit hapësinor
Titulli i pozitës së punës	Zyrtar i lartë për planifikim hapësinor – Projekt
Arsyeja për rekrutim kontraktual	Për realizimin e një projekti
Koeficienti/Paga	770 bruto
Nr. i kërkuar	1
Kohëzgjatja e emërimit	6 muaj
Data e njoftimit	05/05/2026
Afati për aplikim	06/05/2026 - 12/05/2026
Institucioni	Komuna Hani i Elezit
Departamenti	Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor
Divizioni	
Vendi i punës	Komuna Hani i Elezit
Nr. i Referencës	RN00019713
Kodi	RPC0013252

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- 1.Pjesëmarrja në Ekipën Komunale të Planifikimit.
- 2.Përfshirja e kërkesave të palëve dhe të drejtorive Komunale në pjesën narrative të HZK-së.
- 3.Përfshirja e të dhënave gjeohapësinore në pjesën hartografike të HZK-së.
- 4.Prezantimi i të dhënave narrative dhe hartografike të HZK-së në debate publike.
- 5.Hartimi i raportit përfundimtar të shqyrtimit public HZK-së.
- 6.Hartimi i dokumentit final të HZK-së në harmoni me PZHK.

2.Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

Arsimimi i kërkuar : Zyrtar për planifikim hapësinor:Arsimimi i kërkuar:Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në Planifikim hapësinor (planifikim regjional, urban, rural, transportit dhe mjedisit), Arkitekturë dhe Gjeografi.

përvoja e punës: së paku 3 vite përvojë pune në planifikimin urban , hartimi i masterplaneve ose projekteve të ngjajshme



4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- /1.Grupi i planifikimit hapësinor.
- 2.Certifikatat për trajnime të specializuar në planifikim hapësinor ose zhvillim urban janë përparësi.
- 3.Minimum 3 vjet përvojë pune në planifikimin urban, hartimin e mastërplaneve ose projekteve të ngjashme.
- 4.Përvoja në hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe bashkëpunimin me komunitetin ose autoritetet lokale.
- 5.Njohuri të mira në përdorimin e softuerëve të vizatimit teknik si AutoCAD, GIS etj.
- 6.Aftësi për të kryer analiza të terrenit, harta dhe materiale të dokumenteve të planifikimit.
- 7.Posedimi i aftësive të mira për komunikim verbal dhe shkrim.
- 8.Kapacitet për të shpjeguar konceptet tek palët e ndryshme dhe për të punuar në ekipe të ndërdisiplinore.
- 9.Aftësi për planifikim, organizim dhe menaxhim të kohës gjatë përfundimit të projekteve brenda afateve të përcaktuara.
- 10.Njohje e mire e ligjeve, rregulloreve dhe politikave që lidhen me planifikimin dhe zhvillimin urban.
- 11.Të jetë i hapur për bashkëpunim me komunitetin, konsultime publike dhe ndërgjegjësim për rëndësinë e planifikimit të qëndrueshëm.



5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit(vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal.
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike). Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit.
- Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit.

- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se(6) muaj nga data e lëshimit.
- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore.
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 27/05/2026, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Kriteret specifike shtesë

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Intervista – maksimumi 100 pikë

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



10. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

- Pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, njësia përgjegjëse bën verifikimin para emërimit me qëllim të vërtetimit se kandidatët vazhdojnë të plotësojnë kriteret e konkursit, përmes dokumenteve në origjinal apo të njësuara me origjinalin.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

